



"Forcimi i rolit të shoqërisë civile në promovimin e principeve të mirëqeverisjes në luftën kundër korrupsionit në sistemin dhe strukturën e qeverisjes lokale"

Konteksti i projektit

Ky projekt është fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të OSHC në 5 qytete (Kamza, Shijak, Çorovodë, Përmet dhe Laç) për të ndërmarrë një rol aktiv në promovimin e principeve të mirëqeverisjes në nivel lokal. Gjithashtu në inkurajimin e OSHC-ve në monitorimin e aktiviteteve të qeverisjes lokale, me qëllim zhdukjen e korrupsionit nëpërmjet proceseve transparente dhe rritjes së influencës në administratën publike, ku korrupsioni në çfarëdo vlerë është i pa tolerueshëm.

Aktivitetet Kryesore:

- Rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për t'u angazhuar në proceset e qeverisjes lokale.
- Përmirësimi i transparencës dhe bashkëpunimit ndërmjet qeverisjes lokale dhe OSHC rajonale.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me masat dhe veprimet anti-korrupsion.

Aktivitetet u grupuan sipas detyrave të mëposhtme:

Detyra 1: Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të OSHC në secilin prej qyteteve të përzgjedhur së bashku me çështjet kryesore ku ato kanë më tepër nevojë për trajnime dhe asistencë me qëllim ngritjen e kapaciteteve, dhe më konkretisht: funksionet dhe kompetencat e qeverisjes lokale, leadership, advokim dhe lobim etj.

Detyra 2: Organizimi i Trajnimeve për OSHC lokale dhe stafin e Zyrave të Informimit



Publik pranë bashkive në mënyrë interaktive, duke kombinuar prezantimin e informacioneve dhe materialeve me diskutimin e pjesëmarrësve në lidhje me eksperiencat e tyre për çështjet problematike në fushën e komunikimit dhe transparencës ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale në qytetet e tyre. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve të OSHV-e dhe administratës publike për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë e qeverisjes lokale kundrejt nevojave të komunitetit.

Detyra 3: Ngritja e rrjeteve të shoqërive civile në çdo qytet, duke zgjedhur një OSHC si drejtuese të rrjetit, për të mbrojtur nevojat dhe kërkesat e komunitetit për një qeverisje të përgjegjshme dhe efektive. Qëllimi kryesor në këtë fazë ishte ngritja e rrjeteve civile dhe institucionalizimi i tyre për të ndërmarr veprime dhe për të përgatitur produkte konkrete në kuadrin e përmirësimit të transparencës dhe mbrojtjes së interesit të komunitetit.

Detyra 4: Rishikimi i kuadrit institucional për funksionimin e Zyrave të Informimit Publik

në bashki në mënyrë që të përmirësohet shërbimi i informimit publik si dhe cilësia e materialeve informuese për qytetarët. IKU ka asistuar në përgatitjen e një gazete lokale në lidhje me strukturën e përmbajtjes, funksionet përfshirës, procesin e përgatitjes, mënyrën e promovimit dhe kanalet e shpërndarjes tek qytetarët.

Detyra 5: Asistencë direkte për rrjetet e OSHC në zbatimin e vlerësimeve mbi fusha specifike të qeverisjes lokale.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ OSCE

KOHËZGJATIA:

Maj 2010 – Shkurt 2011

PËRFITUESIT:

- ✓ OSHC

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtore Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.